

Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit shpall vendet e punës si më poshtë:

I. Departamenti i Gjeologjisë, kërkon të punësojë 2 (dy) personel akademik me kohë të plotë. Kriteret e punësimit janë si më poshtë:

1. Të këtë formim universitar (Bachelor dhe Master i Shkencave) në Inxhinieri Gjeologjike.
2. Preferohen kandidatët që kanë diplomë të Nivelit të Dytë "Studime të Integruara të Nivelit të Dytë në Gjeologji", "Master i Shkencave" në Gjeomjedis, Gjeoinformatikë.
3. Nota mesatare (Bachelor + Master i Shkencave) mbi 8:00.
4. Të këtë njohuri të mira në fushat e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, sistemet kompjuterike (Windows, Excel, Linux) etj.
5. Njohuri të mira të gjuhës angleze, të dokumentuar me dëshmi përkatëse, së paku niveli B1, përbën avantazh njohja e gjuhës angleze në nivelin C1. Përbën avantazh njohja e një gjuhe tjetër të BE si gjermanisht, italisht, serbokroatisht.
6. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

II. Departamenti i Klimës dhe Mjedisit, kërkon të punësojë 1 (një) personel ndihmësakademik me kohë të plotë. Kriteret e punësimit janë si më poshtë:

1. Kandidatët duhet të kenë fituar Diplomë Bachelor dhe Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedis, Gjeografi.
2. Kanë përparësi kandidatët që kanë diplomë Master i Shkencave/Master Profesional në fushën e Klimës.
3. Kanë përparësi kandidatët që kanë njohuri universitare të lëndëve të Klimatologjisë.
4. Kandidatët duhet të kenë njohuri të Anglishtes (e dokumentuar), preferohen kandidatë që kanë njohuri të një gjuhë tjetër të Komunitetit Evropian.
5. Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë pune në fushat e meteorologjisë, klimës, mjedisit.
6. Preferohen kandidatët që kanë pjesëmarrje në konferenca shkencore apo publikime në fushat e meteorologjisë, klimës, mjedisit.
7. Preferohen kandidatët që kanë kryer trajnime, certifikime pasuniversitare në fushat e meteorologjisë, klimës, mjedisit.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **05.03.2021** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.